



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0004

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhani-kryetare, duke vendosur sipas ankesës së OE "AS Tech" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve” me numër të prokurimit 632-23-5490-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më 12/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "AS Tech" SH.P.K. e datës 03/01/2024 me nr. protokolli 2024/0004, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve”, me numër të prokurimit 632-23-5490-1-2-1, inicuar nga KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).
2. Vërtetohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E GJAKOVËS i datës 15.12.2023.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 30.05.2023, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve” me numër të prokurimit 632-23-5490-1-2-1. Ndërsa me datën 15.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 49,982.20 €.

Me 20.12.2023, OE " AS Tech " SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE " AS Tech " SH.P.K me nr. 2024/0004 lidhur me aktivitetin "Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve" me numër të prokurimit 632-23-5490-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre, ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE " AS Tech " SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon se "OE i rekomanduar nuk i ka plotësuar kërkesat e AK-së, Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë si dhe kërkesën Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 4 (katër) serviserat të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e furnizimit. OE nuk ka referenca të kësaj natyre dhe rrjedhimisht nuk e ka plotësuar kërkesën teknike profesionale. OE po ashtu nuk e ka stafin e certifikuar siç e ka kërkuar AK. OE Uraniku përveç që nuk e ka sjell certifikatën për një serviser, stafin për të cilët ka sjell certifikatat të servisimit nuk janë pjesë e listës së stafit. Kërkesa e AK-se ka qenë: Lista e punëtorëve, CV-a, certifikatat profesionale, kontrata e punës valide me ofertuesin, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë. OE Uraniku ka sjell vetëm disa certifikata por ata janë të personave që nuk janë pjesë e listës, përderisa janë dokumente të personave jashtë listës nuk duhet të merren në vlerësim aspak, sepse AK vete ka kërkuar të dorëzohet lista e punëtorëve. OE është dashur të dorëzojë Listën e tere stafit të angazhuar për këtë projekt të cilët kanë mund të jene të rregullt apo të angazhuar me parakontrate, por që duhet me çdo kusht të jene të listuar si staf, e pastaj nga lista e prezantuar AK ka mundur të kërkojë sqarime tjera, ndërsa kur punëtorët nuk janë të shkruar në liste nuk mund të kërkojnë sqarime për ta. Nga qasja që patëm, pame që komisioni ka kërkuar sqarime për staf por që nuk e patëm të qarte për qka është kërkuar sqarime, sepse stafi për të cilin ka kërkuar sqarime nuk janë pjesë e listës së stafit që AK ka dorëzuar. Është kërkuar liste e stafit me dëshmitë përcjellëse, OE ka mund të sjell dëshmi shtese por jo edhe të ndryshoj listën apo të plotësojë atë sepse nuk lejohet me ligj të prokurimit, dëshmitë që AK i ka kërkuar janë dokumente pa interes me objektin e lëndës sepse nuk janë figuruar

fillimisht ne Kërkesën e AK për dorëzim të listës së nënshkruar.”

Pretendimi i dytë (II) Ankuesi pretendon se: “OE Inifinit nuk ka dorëzuar dëshmi për certifikata të stafit të kërkuar, ndërsa AK në letër standarde për eliminim e cek vetëm arsyen e eliminimit që ne oferte të tij OE INFINIT nuk e ka nënshkruar Listën e stafit. AK këtu i bene dy gabime, përveç që si cek të gjitha të gjeturat për ofertën e INFINIT, gabimin tjetër e bene kur e "demanton" vendimin e saj të datës 15.12.2023, kur e shpërblen OE Uraniku me liste të mangët, ndërsa ofertën e INFINIT e eliminon me arsyen se nuk e ka plotësuar listën e punëtorëve (nuk e ka dorëzuar aspak). DMTH AK e eliminon ofertën e INFINIT sepse nuk ka liste ndërsa e shpërblen ofertën e Uranik me një liste që se ka tere stafin e kërkuar dhe të listuar, këtu AK nuk ka bere vlerësim objektiv sepse rastet e njëjta i ka trajtuar ndryshe dhe kjo nuk është e lejuar me ligj të prokurimit. Këtu AK ka përdorur standarde të dyfishta, përkundër kësaj ne nuk e kontestojmë çështjen se oferta e Inifinit nuk është e përgjegjshme për arsyet e cekura me lartë.”

Pretendimi i tretë(III) -Ankuesi pretendon se: “Komisioni i vlerësimit nuk i ka paraqitur të gjitha gjetjet në letër standarde për eliminim vetëm arsyen se nuk e ka nënshkruar Listën e stafit siç e shtjelluam edhe në pretendimin të INFINIT. Komisioni i vlerësimit askund në Raport apo letër standarde për eliminim nuk e cek atë që GOE Kiga dhe Lamkon nuk e kanë plotësuar kërkesën në kapacitete teknik për sjelljen e dëshmimeve për referenca të ngjashme, referencat që GOE ka sjell nuk janë as të natyrës së klimave, AK në asnjë rrethanë nuk duhet që vetëm fjalën Furnizim ta trajtoj njëjtë sepse kjo qeshje është gjykuar në shume e shume raste në OSHP që furnizimet pranohen vetëm kur janë të natyrës së njëjtë ose të ngjashme dhe jo çfarëdo furnizimi që si përket aspak klimave. Ju si AK në kontrate keni parapare Furnizimi madje edhe serviserat të certifikuar, d.m.th. keni kërkuar kompani të specializuara në këtë fushe dhe është shume e paqarte se si këtij Gr. të OE nuk ja keni cekur këtë mangësi, dhe ja keni pranuar Furnizimet që si përkasin aspak kësaj natyre. OE nuk ka referenca të kësaj natyre dhe rrjedhimisht nuk e ka plotësuar kërkesën teknike profesionale. OE po ashtu nuk e ka stafin e certifikuar siç e ka kërkuar AK.

Pretendimi i katert (IV) -Ankuesi pretendon se: “Komisioni i rivlerësimit nuk ka kërkuar aspak sqarime në proces të rivlerësimit ashtu siç OSHP e ka cek në Vendimin e saj për këtë lende. AK nuk e ka shpërblyer ofertën e As Tech si të vetme të përgjegjshme, pas gjithë këtyre shkeljeve që u cekun në ofertat tjera. Përfundimisht Kërkojmë APROVIM të kërkesës tonë për rishqyrtim, kthim të lëndës në rivlerësim dhe shpërblim të ofertës tonë me kontratë.”

Pretendimi i pestë (V) -Ankuesi pretendon se: “AK ka për detyrë shqyrtimin e të gjitha pretendimeve të parashtruara në Kërkesën për rishqyrtim, ndërsa në këtë rast në kërkesën tone për rishqyrtim nuk janë shqyrtuar aspak 2 pretendime të kërkesës për rishqyrtim. Mos shqyrtimi i një pretendimi është njësoj se mos shqyrtimi i tere kërkesës për rishqyrtim sepse OE ka të drejtë të sqarimeve në pika ose pretendime të caktuara dhe jo AK ta shqyrtoj me një përmbledhje të përgjithshme si "refuzohet kërkesa për rishqyrtim", sepse po nënkuptohet se AK nuk po i mbron pretendimet me sqarime por në fakt po e mbron Vendimin e saj. Po ashtu AK nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së nr. 2023/537 që të kërkoj sqarime nga ofertat e përgjegjshme për plotësim të dokumentacionit që lejohet me ligj, AK nuk ka kërkuar aspak sqarime gjatë procesit të rivlerësimit për kompaninë tone.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE " AS Tech " SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-së duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet vendimi i AK dhe të kthehet në rivlerësim aktiviteti i

prokurimit.

Përgjigje e KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e saj si AK- ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE " AS Tech " SH.P.K, sipas së cilit, refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim dhe vërtetohet vendimi i AK, sepse operatori i rekomanduar për kontratë sipas komisionit vlerësues profesional i ka plotësuar të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktues siç edhe janë kërkuar në FDT. I njëjti ka dorëzuar certifikatat, CV, kontratat dhe para kontratat me titullin e projektit për të cilin janë lidhur këto para kontrata. AK, të gjitha kërkesat për sqarime shtese i ka bërë në përputhje me LPP. nuk qëndron po ashtu as pretendimi tjetër i ankuesit sepse Operatori i rekomanduar për kontratë ka prezantuar listën e stafit kurse operatori ekonomik Infinit nuk ka prezantuar fare listën e stafit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 04.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0004 dhe me datë 04.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0004 me rekomandimet si në vijim: “Duke pasur parasysh shqyrtimin e të gjitha pretendimeve ankimore dhe krahasimit të tyre dhe bazuar dhe mbështetur në kriteret e dosjes së tenderit si dhe legjislacionin në fuqi për prokurimin publik vlerësoj dhe konstatoj se pretendimet ankimore janë të pa bazuar dhe se ankesa e operatorit ekonomik të refuzohet si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendimin e AK-së.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është deklaruar se pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertin shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE " AS Tech " SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0004 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin e parë (I) –Eksperti shqyrtues sqaron se Operatori ekonomik „Uranik - SG SHPK " në dosjen e ofertës ka prezantuar listën prej (7) shtat kontratash. Duke bashkangjitur si dëshmi kësaj liste edhe kontrata dhe referencat të cilat janë konform listës së prezantuar. Bazuar në dëshmitë e prezantuara në ofertë të operatorit ekonomik në cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatoj se i njëjti ka prezantuar kontrata dhe referenca të aktiviteteve të mirëmbajtjes sipas prokurimit të kërkuar nga AK, po ashtu ka prezantuar edhe kontrata të furnizimeve të ngjashme me prokurimin e AK dhe se i njëjti konstatoj se plotëson kriterin e kërkuar nga AK dhe pretendimi ankimore se i njëjti nuk ka referenca sipas kërkesë se AK nuk është i pa bazuar. Me tutje, Eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ka prezantuar në ofertë listën me gjithsejtë 14 punëtorë, Por AK në dosjen e tenderit ka kërkuar që OE ofertues të ketë katër (4) serviser. Operatori ekonomik pjesë të listës ka vetë dy (2) serviser për të cilët ka prezantuar edhe dokumentacionet e kërkuar në dosjen e tenderit (CV, Kontratën e punës dhe Certifikatën profesionale). Stafi i servisereve të cilët janë pjesë e listës janë: Smajl Gashi nr. rendor në listë 11 dhe Fazli Gashi nr. rendor në listë 4. Provë: Listën e punëtorëve, dhe Certifikatat profesionale të kërkuara për disa punëtor, Certifikata serviserit për punëtorin e paraqitur edhe në listë Smajl GASHI, Certifikata serviserit për punëtorin e paraqitur edhe në listë Fazli GASHI. Por operatori ekonomik nuk ka dy (2) serviser pjesë të listës, megjithatë ka të

dorëzuar dokumentet e tyre sipas kërkesës së AK (CV, Para kontratë dhe Certifikatat profesionale). Staf i serviserëve të cilët kanë dokumentacionin e kërkuar në ofertë por që nuk kanë emrat në listë janë: Valon Gjergjizi dhe Shpëtim Krasniqi. Provë: Certifikata serviserit për punëtorin e që nuk është në listë Valon GJERGJEZI, Certifikata serviserit për punëtorin e që nuk është në listë Shpëtim KRASNIQI. ndaj duke pasur parasysh se i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga ana e AK lidhur me kërkesën për serviser është i dorëzuar nga ana e OE të rekomanduar përveç se dy (2) emra të serviserëve nuk janë pjesë e listës po që të njëjtit kanë dokumentet e kërkuara në ofertë në cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatohet se në ofertën e operatorit ekonomik janë gjithsej 4 serviser, andaj bazuar në Nenin 59 paragrafin 4 pikën Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse (ii) e përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundur, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Andaj bazuar në këtë në cilësinë e eksperti edhe njëherë konstatohet se serviseret të cilët nuk janë pjesë e listës kanë tërë dokumentacionin e kërkuar në ofertë dhe mos prezencë e tyre në listë konsiderohet se është vetëm devijim i vogël dhe që nuk ndryshon kushtin material dhe konceptin e prokurimit dhe konsiderohet se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar. Duke pasur parasysh këtë konstatohet se OE i ka prezantuar serviseret dhe Certifikatat e tyre sipas kërkesës si dhe listën e punëtorëve, në DT janë kërkuar 4 serviser, andaj bazuar në këtë pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin e dytë (II) – Eksperti shqyrtues sqaron lidhur me pretendimin ankimor se AK nuk ka çekur gjetje tjera në letrën standarde të OE edhe pse parimisht OE ankues pajtohet me eliminimin e OE „INFINIT nga ana e AK në cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatohet se procedura e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave është kompetencë e AK-së dhe se AK lidhur me këtë ka zbatuar Nenin 59 të LPP, dhe Vendimin e PSH.OSHP nr.2023/0537 të datës 21.11.2023 pasi që ka shpallur të pa përgjegjshëm operatorin ekonomik. Në bazë të kësaj Eksperti shqyrtues në bazë të Rregullores Nr.01/2020 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Nenin 16 (Rastet e unifikuar) paragrafi 2 dhe 3 që citohet: Në rastet e përsëritur me pretendimet të njëjta ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjtat për rastet të cilat janë shqyrtuar edhe më parë duhet që të trajtohen si çështje të gjykuara “res juridikat” në kuptim të Nenit 105 paragrafit 2.16 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin e tretë (III) – Eksperti shqyrtues sqaron lidhur me pretendimin ankimor se AK nuk ka çekur gjetje tjera në letrën standarde të OE edhe pse parimisht OE ankues pajtohet me eliminimin e OE „KIGA dhe OE „LAMKOS” nga ana e AK në cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatohet se procedura e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave është kompetencë e AK-së dhe se AK lidhur me këtë ka zbatuar Nenin 59 të LPP, dhe Vendimin e PSH.OSHP nr.2023/0537 i datës 21.11.2023 pasi që ka shpallur të pa përgjegjshëm operatorin ekonomik. Në bazë të kësaj Eksperti shqyrtues në bazë të Rregullores Nr.01/2020 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Nenin 16 (Rastet e unifikuar) paragrafi 2 dhe 3 që citohet: Në rastet e përsëritur me pretendimet të njëjta ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjtat për rastet të cilat janë shqyrtuar edhe më parë duhet që të trajtohen si çështje të gjykuara „res juridikat” në kuptim të Nenit 105 paragrafit 2.16 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin e katërt (IV) – Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti kontraktues në bazë të kriterëve të dosjes së tenderit si dhe vlerësimit të ofertave ka bërë publikimin e letrës standarde, oferta juaj është e shpallur e përgjegjshme, dhe me këtë rast ka zbatuar Nenin 59 të

LPP. Por duke pasur parasysh kriterin e dosjes se tenderit çmimi më i lirë i përgjegjshëm konform kriterëve dhe vlerësimit të ofertave është shpallur operatori ekonomik me çmimin më të lirë të përgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

-Konstatimet e panelit shqyrtues-

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Pas administrimit dhe vlerësimit të provave, shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në Ligjin për Prokurimit Publik [LPP] si ligj material të zbatueshëm, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të refuzohet si e pa bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve" me numër të prokurimit 632-23-5490-1-2-1.

Ankuesi mes tjerash ka pohuar se AK pa të drejtë dhe në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së kishte kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar lidhur me dy serverët, sepse sipas tij/saj te njëjtit nuk janë përfshirë në listën e punëtorëve si kërkesë e veçante. Eksperti shqyrtues lidhur me këtë ka sqaruar se OE i rekomanduar në ofertën e tij/saj ka paraqitur një listë me 14 punëtorë, kurse si kërkesë specifike në dosjen e tenderit [DT] ishte kërkuar që OE-të, të kishin në total katër (4) serviserë. Pas administrimit të provave është vërejtur se në listën e punëtorëve të paraqitur nga OE i rekomanduar për kontratë nuk janë të përfshirë katër (4) serviserët, d.t.th. i njëjti ka përfshirë vetëm dy (2) serviserë për të cilët ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar (CV, kontratë pune dhe certifikatë profesionale). Kurse për dy (2) serviserë të tjerë. V. Gj. dhe 2. Sh. K [emri në shkresat e lëndës] të cilët nuk ishin evidentuar në listën e punëtorëve në kohë, megjithatë është fakt se i njëjti me kohë kishte paraqitur brenda ofertës së tij/saj të gjithë dokumentacionin e kërkuar për këtë kërkesë, përfshirë para-kontratën e punës me serviserët dhe certifikatat profesionale të noterizuara. Andaj bazuar në të lartcekurat eksperti në raportin e tij/saj kishte konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e DT, pa nevojë që të njëjtat të përshkruhen sërish në detaje, duke përfshirë njëherësh edhe kërkesën specifike për katër (4) serviserë, kurse mos evidentimi i tyre me kohë në listën e punëtorëve, nuk e bënë të papërgjegjshëm këtë OE, duke shtuar me tej se AK, ka vepruar në harmoni me nenin 1,6 dhe 59 të LPP-së sepse ka të drejtë në rrethana të tilla të konsiderojë një lëshim të tillë si "devijim i vogël".

Lidhur me këtë Paneli shqyrtues sipas gjykimit të tij pavarur, konsideron se meqenëse një devijim i tillë, duke ju referuar gjithnjë të drejtës së AK, konform nenit 59.4 të LPP, nuk i ndryshon kushtet, karakteristikat dhe nuk ndikon në ekzekutimin e kontratës në fjalë, e duke pasur parasysh njëherësh që AK janë të detyruara të sigurojnë po ashtu që fondet dhe burimet publike të përdoren në mënyrë sa më ekonomike, marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, sipas nenit 1 dhe 6 të LPP, duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të

veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se shpjegimet e dhëna në raportin e ekspertizës (pa nevojë që të gjitha ato sërish të përshkruhen dhe të komentohen) janë të arsyeshme dhe të mjaftueshme lidhur me krijimin e gjykimit në këtë rast, se ankesa nuk është e bazuar.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues analizoi në kontekstin e përgjithshëm të këtij aktiviteti të gjitha pretendimet reciproke të palëve (Ankuesit dhe AK) dhe ato se çfarë përmban raporti i ekspertit, duke i analizuar me ndërgjegje dhe kujdes profesional dhe erdhi në përfundimin, sipas bindes së tij të pavarur se ankesa nuk mund të pranohet si e bazuar andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

AK gjatë zbatimit të dispozitave të LPP dhe legjislacionit dytësor gjithmonë duhet të bazohet edhe në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuesenjëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Paneli shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në harmoni me kriteret e vendosura në dosjes së tenderit dhe se veprimet e AK janë në hermoni me tjerash me nenin 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve) dhe nenin 60 (Kriteret për Dhënie të Kontratës).

Ndonëse raporti i ekspertizës dhe rekomandimet që i përmban nuk përbejnë detyrim as për palët e as për OSHP-në, në çdo rast Panelet Shqyrtuese e vlerësojnë dhe analizojnë karakterin e tyre dokumentues, në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të një lënde dhe administrimit të provave.

Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe konform nenit 117 të LPP, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Kurse, lidhur me tarifën ankimore, është vendosur në kuptim të nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së, lidhur me nenin 118 të LPP

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - " AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: